

## **BULETINI I IGJK Nëntor/Dhjetor 2004**

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me qështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

### **Informata të fundit rreth programit trajnues të IGJK-së në vitin 2005**

Ky dokument përshkruan përmbajtjen e trajnimeve të propozuara për vitin 2005. Është një document i bazuar në vlerësimin e nevojave, kontributin e IGJK-së dhe në rezultatin e konferencës së programit që u mbajt më 18 tetor 2004. Pritet që shumica e trajnimeve të zgjasin nga 2 ditë dhe të mbahen në vende të ndryshme në të pesë rajonet e Kosovës. Shpenzimet e transportit, ushqimit dhe fjetjes së pjesmarrësve do të mund të sigurohen varësishtë nga mjetet financiare në dispozicion. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët inkurajohen që paraprakishtë të përzgjedhin trajnimet në të cilat ata dëshirojnë që të marrin pjesë. Programi përfundimtar i trajnimeve që do të freskohet në çdo tre-mujor do të themelohet sipas nevojave të paraqitura dhe aplikacioneve të dorëzuara për pjesmarrje.

#### **1. Trajnimi ndër-sektorial.**

##### **1. Seminar: Etika në praktikë: pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit.**

Përfitues të këtij trajnimi janë gjyqtarët. Ky trajnim ka për qëllim që t'jap një pasqyrim më të detajuar në përvojën praktike ku pavarësia e gjyqtarëve mund të jetë brengosëse. Seminatri do të përqëndrohet në pozitën e gjyqtarit si një vendimmarrës personal apo si një vendimmarrës në kolegji. Ky seminar do të theksoi përgjegjësinë e gjyqtarit sa i përket sundimit të ligjit dhe rendit social në kontekst të kodeve të mirësjelljes dhe sanksioneve disiplinare.

Seminari do të bazohet në përvojën e fituar në trajnimin e mëparshëm më temë të njejtë dhe trajnimin e fundit të organizuar nga Projekti për ndërtimin institucional të IGJK-së dhe qendrës

kombëtare për gjykatat shtetërore të SHBA-ve që është mbajtur në nëntor të vitit 2004. Një element i ri që duhet të iu prezantohet pjesmarrësve është teknika e sjelljes gjatë komunikimit me gazetarët dhe mediat.

Metodat: ligjerime, raste studimi, dhe ushtrime grupore.

##### **2. Punëtori: Interpretimi i ligjeve në konflikt.**

*Përfitues të këtij seminari janë gjyqtarët. Qëllimi i këtij trajnimi është që të gjyqtarët dhe prokurorët të marrin udhëzime rreth konflikteve në mes ligjeve që kanë qenë në fuqi para vitit 1989 dhe legjisllacionit që është nxjerrur duke përfshirë edhe Rregulloret e UNMIK-ut. Punëtorja do të ngrisë diskutime rreth aplikimit të ligjeve ndërkombëtare nga gjyqësia e Kosovës. Pjesmarrësit do të pyeten që të sigurojnë kontributet e tyre në temat e*

mundshme të ligjeve në konflikt dhe do të inkurajohen që të bëjnë propozime për doracakun rreth ligjeve të aplikueshme që janë në konflikt.

**3. Seminar: Shkenca dhe teknologjia nëpër gjykata** Ky seminar do të siguroi gjyqtarët dhe prokurorët me informata rreth mundësive teknike të aplikueshme nëpër gjykata. Pas kompletimit të seminarit pjesmarrësit do të kanë një kuptim më të gjërë të teknikave të hetimeve dhe marrjes së provave dhe rreth rolit të ekspertëve në procedimin e rasteve.

**4. Seminar dhe aktivitet: Ligjet e Bashkësisë Evropiane**, në kontekst të përkushtimeve që Kosova do t'i ketë në të ardhmen ndaj BE-së, gjyqësori do të ketë nevojë për një pasqyrim të përgjithshëm të temave siç është Kriteriet e Kopenhagës implementimi i "acquis communautaire" etj. Grupi i trajnuesve do të përbëhet nga gjyqtar/prokuror nga secili rajon. Pjesmarrësit e këtij trajnimi do të kenë mundësinë që të bëhen trajnues të ligjeve të BE-së në IGJK dhe mund të iu ofrohet një udhëtim studimi jashtë vendit nëse kanë marrë pjesë në të dy aktivitetet trajnuese.

**5. Seminar: Të drejtat e njeriut dhe procedura penale në praktikë.** Grupi përfitues gjyqtarët dhe prokurorët e lëmisë penale. Qëllimi i këtij seminari është që të zhvilloi një kuptim më të gjërë të pjesmarrësit rreth koncepteve "procedurë e rregullt" dhe "gjykim i drejtë". Pjesmarrësit do të kenë mundësi që të identifikojnë shkeljet e mundshme të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga ligjet e aplikueshme, dhe do të marrin aftësi të

reja në marrjen e vendimeve dhe hartimit të arsyetimit në rastet që rezultojnë me shkelje të tilla. Metodrat e trajnimit do të përqëndrohen më shumë kah rastet praktike.

## II. E drejta Penale

**6. Seminar: Krimet e luftës.** Ky seminar do të përqëndrohet në krimet e luftës në Kosovë e që nuk janë shqyrtuar nga Tribunali i Hagës (T.H). Seminari ka për qëllim ngritjen e diturisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve drejt një roli aktiv, ata duhet të veprojnë në mënyrë graduale për të tejkaluar problemet e këti lloji të procedurës.

**7. Seminar: Ligji për të miturit.** Ky trajnim do të përfshij Kodin e ri të drejtësisë për të Mitur dhe procedurat gjyqësore ku janë të përfshirë të miturit, me përqëndrim të veçantë në aspektet siç janë kompetencat, masat edukuese provuese.

**8. Seminar Larja e parave dhe krimet Ekonomike** grupet përfituese – prokurorët dhe gjyqtarët me përvojë të mëparshme ose të specializuar në këtë lëmi. Seminari gjithashtu do të paraqes edhe krime tjera ekonomike. Kjo ngjarje në vitin 2005 do të organizohet në bashkëpunim të plotë me ekspertët ndërkombëtar.

**9.Seminar:Bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale dhe ekstradimi.** Një seminar rreth dispozitave të reja rreth ndihmës ndërkombëtare gjyqësore është caktuar që të mbahet në nëntor të vitit 2005 dhe do të jetë përsëritje e seminarit me të njëjtën temë të mbajtur në vit 2004. Kjo ngjarje e nëntorit 2005 do të

organizohet në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët ndërkombëtar.

**10. Punëtori: Bashkëpunimi në procedurat paraprake.** Përfitues të këtij seminari do të jenë prokurorët, gjyqtarët e procedurës paraprake dhe policia gjyqësore nga të gjitha rajonet. Qëllimi i kësaj punëtorie është që së bashku me trajnuesit e shkollës policore të formoi një dituri të përbashkët rreth përgaditjes së dokumenteve gjatë procedurës paraprake dhe udhëheqjes së hetimeve në vendin e ngjarjes.

**11. Punëtori: Paqartësitë dhe kontradiktat në aplikimin e Kodit Penal dhe atë të Procedurës Penale.** Grupet përfituese të kësaj punëtorie janë gjyqtarët dhe prokurorët. Disa tema janë diskutuar tanimë në bashkëpunim me tri Shoqatat atë të Prokurorëve, gjyqtarëve dhe odës së Avokatëve në tetor të vitit 2004 (konfirmimi i aktakuzës), nëntor 2004 dhe dhjetor 2004 (paraburgimi). Tema të reja në grupe punuese duhet të shtohen përshtatshëmrishtë dhe mund të përfshijnë edhe mbrojtjen e dëshmitarëve, dënimeve alternative dhe lirimit me kusht, denimeve me kusht, burgimi shtëpiak, roli i viktimës apo palës së dëmtuar në vendosjen e datës së paraburgimit në rastet e arrestimeve. Punëtorja e parë në janar do të përqëndrohet në shqyrtimin kryesor në përputhshmëri me Kodin e ri të Procedurës Penale.

**12. Seminar: Luftimi i krimit të organizuar, trafikimi me qënjet njerëzore, drogë etj.** Përfitues të këtij seminari janë gjyqtarët dhe prokurorët e lëmisë penale. Ky seminar ka për qëllim të shqyrtoi disa aspekte praktike të luftimit kundër krimit të organizuar siç

është trafikimi i qenieve njerëzore, krimet e ndërlidhura me shpërndarjen e drogës dhe posedimi i paligjshëm i armëve. Programi i këtij seminari do të përqëndrohet në aspekte praktike të hetimeve, sekuestrimit të mjeteve, bashkëpunim ndërkombëtar, mbrojtja e dëshmitarëve dhe personelit të gjykatës, udhëheqja e gjykimeve me avokatët jo-bashkëpunues.

**13. Punëtori rreth kundërvajtjeve:** grupet përfituese janë gjyqtarët dhe prokurorët nga lëmia e kundërvajtjeve. Pjesmarrësit do të shqyrtojnë përgjegjësitë të zvogëlojnë barrën e punës në gjykatat për kundërvajtje duke zhvilluar propozime se si ata i kanë zgjidhur rastet nga përvoja e tyre në praktikë.

**14. Aktivitet vizita në polici** Pjesmarrësit do të njoftohen me zhvillimet e fundit nga lëmia e teknologjisë në fushën e hetimeve. Vëmendja e pjesmarrësve do të përqëndrohet në metodat teknike të hetimeve (përgjimi telefonik, AND) dhe zhvillimet në krime (krimet përmes internetit).

**15. Seminar Zhvillimet e fundit në të drejtën penale dhe atë të procedurës penale.**

Programi trajnues do të përqëndrohet në Rregulloret e reja të UNMIK-ut dhe në zhvillimet e fundit në fushën e të drejtës penale dhe atë të procedurës penale (shembull procedurat me kryesit e veprave me çrregullime mendore, ekzekutimi i sanksioneve penale, përmirësimet eventuale në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale).

### III. E drejta Civile

**16. Seminar: Ligji për antidiskriminim.** Ligji për antidiskriminim është nxjerrur së voni dhe është në fuqi në Kosovë. Seminari ka një qëllim informativ dhe do të paraqes çështjet lidhur me diskriminimin në sektorin privat dhe atë publik. Përvojat Evropiane dhe rajonale dhe problemet e mundshme praktike do të prezantohen nga ekspertët e OSBE-së dhe do të ketë edhe ekspert nga shtetet fqinjë.

**17. Seminar: Zhvillimet e fundit në të Drejtën civile dhe atë të procedurës civile.** Ky seminar do të siguroi informata rreth zhvillimeve të fundit dhe rregulloreve nga lëmia civile në Kosovë të cilat janë në pritje e sipër për të u nxjerrur. Ky seminar do të përqëndrohet edhe në ligjin e ri të banimit, projekt legjisllacionet nga fushat e familjes dhe trashëgimisë, ligjit për obligimet dhe zhvillimet në nivel Evropian. Si shtesë në këtë pjesmarrësve do të u ipet mundësia që të marrin pjesë në ushtrimet grupore rreth rasteve praktike. Do të shtjellohen temat si ujdia,

**18. Punëtori rreth ligjit mbi pronën, kadastrin dhe hipotekën:** grupet përfituese të kësaj punëtorie janë gjyqtarët që gjykojnë rastet e pronës. Kjo punëtori do të ofroi pjesmarrësve diskutime rreth pengesave kryesore që ata i kanë kur gjykojnë rastet që kanë të bëjnë me pronën si psh. Kur Shënimet e nevojshme për regjistrimin e pronës janë të pamjaftueshme apo mungojnë: vështirësitë rreth bashkëpunimit me drejtoratin për çështje pronësore – banesore (DÇPB) etj. Kjo punëtori do të siguroi mundësinë që pjesmarrësit të shkëmbejnë përvojat e tyre me kolegët

dhe mëton të formoi një listë të çështjeve që presin për të u shqyrtuar në praktikë. Në një ushtrim praktik do të paraqiten mjetet për mbrojtjen e pronës private dhe transferimit të pronës shtetërore në pronësi private dhe forma tjera të pronës.

**19.Seminar: Ekzekutimi i Aktgjykimeve civile:** grupi përfitues janë gjyqtarët. Ky seminar ka për qëllim të paraqes në mënyrë të detajuar obligimet dhe përgjegjësitë e reja që kanë gjyqtarët sipas rregulloreve të reja. Ky seminar do të ofrojeë nje vlerësim për mundësitë për bashkëpunim ndër-institucional rreth ekzekutimit të aktgjykimeve.

**20. Cikli i Seminareve:** Ligji afarist. Grupi përfitues: gjyqtarët që gjykojnë rastet civile dhe ekonomike. Ky seminar do të paraqes “botën e investitorëve”. Si informatë shtesë e seminarit do të jetë informata rreth investimeve dhe zhvillimeve ekonomike në të ardhmen në Kosovë. Llojllojshmëria e gjërë e temave të seminarit do të përfshijë temat si: ekonomia, tegu, inkorporimi, ligji mbi investimin dhe bankat, antitrusti, e drejta e autorit dhe tema tjera si fletëbalancimet. etj. Ky cikël i seminareve do të organizohen në module në të cilat mund të merret pjesë pavarësisht se a i keni dëgjuar ato te mëparmet apo jo.

**21. Seminar: Ligji i Punës.** Përfitues të këtij seminaroi janë gjyqtarët që gjykojnë kontestet e punës. Seminari do të siguroi informata rreth zhvillimeve të fundit të legjisllacionit të punës në Kosovë dhe në shtetet e BE-së duke përfshirë këtu edhe çështjet e antidiskriminimit në rastet e punësimit dhe punës.

#### IV. Trajnim për aftësim

##### **22. Teknikat e punës në rastet civile.**

Seminari do të paraqesë një sistem më të mirë të organizimit të ngarkesës në punë. Qëllimi i këtij seminari është që të ndihmoi gjyqtarët dhe prokurorët që të jenë më efektiv në udhëheqjen e barrës së punës, të menagojnë më mirë dhe të parandalojnë stresin në punë.

##### **23. Gjetja e fakteve dhe vlerësimi i provave:**

Gjyqtarët dhe prokurorët që do të marrin pjesë në këtë trajnim do të ngrisin diturinë e tyre rreth menyrës së gjetjes së fakteve, barrës së provave dëshmive të pranueshme dhe të papranueshme dhe do të kanë mundësi që të njihen me teknikave psikologjike dhe sociologjike të hetimeve, roli i ekspertëve në vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve etc.

##### **24. Si të përpilohen Aktgjykime të bindshme në rastet civile:**

Ky trajnim do të siguroi një kuptim më të gjërë për pjesmarrësit rreth teknikave për përpilimin e vendimeve të bindshme. Ata do të mësojnë më shumë rreth vendimet e mëparshme mund të shfrytëzohen dhe si mund të harmonizohen vendimet e instancave të ndryshme.

##### **25. Si të përpilohen Aktgjykime të bindshme në rastet penale:**

Përfitues janë gjyqtarët që gjykojnë rastet penale. Ky trajnim ka për qëllim të përmirësoi aftësitë e hartimit në letër. Pjesmarrësit do të kenë një trajnim praktik rreth përcaktimit të dënimeve, shqyrtimin e dëshmive, paraqitjen në gjyq të rasteve penale etc. Pjesmarrësit do të kenë mundësinë të diskutojnë situatë tipike të

jetës së përditshme si psh. Mungesa e dëshmitarëve , ekspertët joaktiv apo avokatët jo-bashkëpunues.

##### **26. Interpretimi dhe zhvillimi i ligjit nga gjyqtarët:**

Trajnimi do të siguroi dituri praktike për gjyqtarët rreth harmonizimit të ligjeve të aplikueshme në Kosovë. Ky trajnim do të zhvilloi diturinë e gjyqtarëve rreth aspekteve praktike të hulumtimeve ligjore dhe përfshirjen e tij në vendimet gjyqësore. Ky trajnim do të vlerësoi rrethanat në bazë të të cilave interpretimi i ligjeve është i aplikueshëm.

##### **27. Trajnim kompjuteri dhe interneti për fillestarët:**

Ky trajnim ka për qëllim të hap “botën e teknologjisë Informative” për ata gjyqtarë dhe prokuror të cilët deri më tani nuk kanë pasur përvojë me kompjuter, do të shtjellohen programet MS Word Office dhe Interneti. Ky trajnim do të siguroi informim më të gjërë rreth mundësisë së publikimit të Aktgjykimeve përmes internetit dhe kështu të informohen edhe gjyqtarët tjerë se si gjykatat po shqyrtojnë rastet e ngajshme dhe si mund të arrihet një harmonizim më i mirë i vendimeve gjyqësore.

#### V Trajnim për avansim në karrierë

##### **28. Trajnim për avansim në karrierë, administrimi dhe udhëheqja e gjykatës:**

Përfitues të trajnimit do të jenë njerëzit që kanë qëllime të zhvillimit të karrierës së tyre. Pjesmarrësit në këtë trajnim do të përfitojnë aftësi themelore administrative dhe aftësi të udhëheqjes së personelit, aftësi rreth përmbledhjeve bugetore dhe bashkëpunimit me organet ndërkombëtare. Qëllimi i këtij trajnmi është që të siguroi mundësi për

të fituar aftësi të nevojshme të udhëheqjes, komunikimit dhe aftësi për udhëheqës. Ky trajnim do të hartohet dhe do të organizohet në bashkëpunim të ngushtë me DAGJ.

**29. Udhëtim studimet jashtë vendit** përfitues do të jenë gjyqtarët dhe prokurorët. Në mënyrë që të përzgjedhen për vizita studimore jashtë

vendit dhe në mënyrë që të kenë mundësinë që të mësojnë nga përvojat e shteteve tjera, pjesmarrësit duhet që të jenë vijues aktiv të programit trajnues të IGJK-së. Kushtët për pjesmarrje dhe detajet e udhëtim studimeve do të komunikohen ndaras.

## **Programi i Aktiviteteve për muajin Nëntor/dhjetor 2004**

### **nëntor 2004**

- Seminar rreth luftimit kundër Trafikimit me Njerëz
- Punëtori rreth Kodit Përkohshëm të Procedurës Penale
- Seminar nga e drejta civile
- Seminar rreth Ndhimes Juridike Ndërkombëtare
- Punëtori rreth Kodit për të mitur në rajonin e Prishtinës

### **Seminar rreth luftimit kundër trafikimit me qenie njerëzore sipas Ligjit vendor dhe Standardeve Ndërkombëtare**

Me datën 4 dhe 5 nëntor 2004 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) në ndërtesën e vet ka mbajtur një seminar dy ditor rreth luftimit kundër trafikimit me qenie njerëzore bazuar në ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare. Ky seminar është sesioni i dytë me radhë i mbajtur gjatë këtij viti brenda kornizës së një programi të përshtatshëm trajnues. Duke u bazuar në doracakun e trajnimeve për anti-trafikim, të hartuar për gjyqtarët dhe prokurorët do të bëhet shkëmbim dhe bashkëpunimi i gjyqësorit me njësinë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore të Paktit të Stabilitetit. Ky sesion dy ditor shtjelloj fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore, zhvillimin dhe përparimin e

ligjit ndërkombëtar rreth kësaj çështjeje dhe ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Ky seminar poashtu u përqëndrua në procedurën hetimore, ndjekjen e rasteve të trafikimit në Kosovë, dhe aspekte të tjera specifike të procedurave penale të trafikimit me njerëz. U shtjelluan edhe temat për mbrojtjen dhe ndihmen e viktimave gjatë procedurës hetimore, ndjekjes penale, gjykimi, bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe ndihma reciproke juridike kundër trafikimit me njerëz. Personat të cilët kontribuan në këtë seminar janë ekspert nga institucionet të ndryshme dhe agjencione përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Ky sesion trajnimi iu adresua gjyqtarëve dhe prokurorëve të lëmisë penale nga gjykata supreme, gjykatat e qarkut, komunale si dhe prokuroritë e Kosovës.

### **Punëtori rreth Kodit Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës**

IGJK në bashkëpunim me shoqaten e gjyqtarëve, atë të prokurorëve dhe oden e avokatve të Kosovës, organizuan një punëtori diskutimesh rreth Kodit Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, ky sesion u mbajt me datën 09, dhe 10, nëntor, 2004 në rajonin e Pejës. Kjo punëtori kryesisht u

përqëndrua në temën e paraburgimit. Gjyqtarët dhe Prokurorët e rajonit të Pejës u ftuan të punojnë dhe diskutojnë në lidhje me vendimet gjyqësore nga të cilat do të dalin dilemat në zbatimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale në praktikë në rastet e paraburgimit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte arritja e standardizimit në interpretimin e dispozitave të reja penale dhe të mundësohet zhvillim më i mirë i praktikës për adresimin e dispozitave të cilat paraqesin dilema. Gjatë diskutimeve, janë nxjerrur disa udhëzime në lidhje me interpretimin dhe qëndrime të përbashkëta se si të zbatohen dispozitat përkatëse në mënyrën më të mirë, të njëjtat do të publikohen nga IGJK. Tre moderatorë kanë drejtuar këtë sesion trajnimi: prokurori publik i qarkut në Pejë, një gjyqtarë nga gjykata e qarkut Pejë dhe një Avokat nga Peja. Një ekspert nga Këshilli Evropës një gjyqtarë dhe një prokuror ndërkombëtar morën pjesë dhe dhanë kontributin dhe rekomandimet e tyre në këtë sesion.

#### Seminar nga e drejta civile

Me datën 18, nëntor, 2004 IGJK në ndërtesën e vet mbajti një seminar rreth përgjegjësisë nga dëmi i shkaktuar nga automjetet (autopërgjegjësia). Temat shtjelluan kompenzimin e dëmit material, përgjegjësinë e pales së tretë dhe sigurimi i automjeteve me përgjegjësi. U prezantuan dhe u diskutuan disa raste të cilat pasqyruan praktikën gjyqësore rreth kësaj çështjeje nga komuna e Prishtinës. Ekspertët të cilët kontribuan në këtë seminar janë: një profesor nga fakulteti juridik i Prishtinës, dy gjyqtarë nga gjykata e qarkut dhe komunale në Prishtinë dhe një trajnues gjyqësor nga IGJK. Ky

session trajnimi ju adresua gjyqtarëve nga lëmia civile në gjykatën supreme, gjykatat e qarkut dhe ato komunale.

#### Seminar rreth Ndhimes Juridike Ndërkombëtare

Duke i marrur parasush kërkesën e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD), Instituti Gjyqësor të Kosovës së bashku me Këshillin e Evropës (KE) organizuan një seminar rreth dispozitave në lidhje me ndihmen juridike ndërkombëtare. Ky seminar u mbajt me datën 25, dhe 26 nëntor, 2004 në Grand Hotel Prishtinë. Ky trajnim dy ditor u përqëndrua në dispozitat që kanë të bëjnë me ndihmen juridike ndërkombëtare. Gjatë ditës së parë u shtjelluan temat në vijim: Kërkesat e adresuara autoriteteve ndërkombëtare për ndihmë ligjore (dërgimi i dokumentave, letër kërkesat), ekzekutimi i aktëgjyqësive dhe transferimi i personave të dënuar, tiparet kryesore të urdhër-arrestit Evropian (aspekte praktike dhe ligjore rreth implementimit të tij), urdhër-arrestit ndërkombëtar (ligji i aplikueshëm në Kosovë dhe elementet praktike). Me datën 26, nëntor, 2004 gjysma e ditës u kushtua diskutimeve rreth transferimit të procedurave, ekstradimit dhe të drejtave të njeriut nga pikëvështrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut praktika gjyqësore dhe elementet praktike të ekstradimit në Kosovë. Ekspertët të cilët kontribuan në këtë seminar janë kryesuesi i njësitit të Policisë Ligjore nga UNMIK-ut Departamenti i Drejtësisë, përfaqësues të tjerë nga ky njësi dhe dy ekspertë nga Këshilli Evropës. Ky trajnim ju adresohet gjyqtarëve, vendor dhe ndërkombëtar prokurorëve dhe zyrtarëve ligjor.

### Punëtori rreth kodit për të mitur, në rajonin e prishtinës

Më 30 nëntor 2004, IGJK në bashkëpunim me UNICEF-in, OJQ-në Terre Des Homes, dhe shërbimin sprovues të Kosovës, kanë organizuar një sesion trajnues rreth Kodit të ri të drejtësisë për të mitur në Prishtinë. Qëllimi i kësaj punëtorie është që të prezantoi analiza rreth implementimit më të vonshëm të Kodit të ri dhe që të përmirësohet koordinimi dhe kyqja e të gjithë akterëve të përfshirë në procedurat e këtij Kodi. Agjenda përmbanë temat në vijim: rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të zyrtarëve sprovues dhe punëtorëve social sipas kodit të ri të drejtësisë për të mitur, si dhe bashkëpunimi i tyre me gjyqësorin; detyrimet e shërbimit sprovues të Kosovës si dhe procedurat e filluara nga prokurori publik kundër të miturve që janë në konflikt me ligjin. Disa raste studimi janë prezantuar dhe diskutuar gjatë trajnimit. Ekspertët që kanë kontribuar në këtë seminar ishin: një gjyqtar nga gjykata e qarkut në Mitrovicë, drejtoresha e shërbimit sprovues në Kosovë, dhe një prokuror nga prokuroria komunale në Prishtinë. Ky sesion trajnues iu është adresuar gjyqtarëve dhe prokurorëve nga gjykatat dhe prokuroritë komunale dhe të qarkut në Prishtinë, zyrtarëve sprovues, punëtorëve social, policëve dhe avokatëve.

### **Dhjetor 2004**

- Seminar rreth administrimit të provave në procedurën civile
- Seminar nga e drejta civile: Servitutet e drejta sendore
- Seminar për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje

- Punëtori Rreth Kodit të përkohshëm të procedurës penale

### Seminar rreth administrimit të provave në procedurën civile

Më datën 2 dhjetor 2004 IGJK organizoi një seminar rreth administrimit të provave në procedurën civile. Ky trajnim u përqëndrua në rolin dhe rëndësinë kësaj çështjeje, procedurën gjatë shqyrtimit kryesor si dhe dëshmitë gjatë procedurës së ankimit. Prezantimet u mbajtën nga një profesor nga fakulteti juridik në Prishtinë, kryetari i odës së avokatëve dhe kryetari i gjykatës së qarkut në Prishtinë.

### Seminari nga e drejta civile: Servitutet - e drejta sendore

Më datën 7 dhjetor 2004 IGJK organizoi një seminar rreth servituteve. Programi trajnues u përqëndrua në servitutet sendore dhe ato personale. Një nga prezantuesit bëri një pasqyrim të përgjithshëm të praktikës së tanishme gjyqësore. Një gjyqtar ndërkombëtar prezantoi një pasqyrim praktik të servituteve në Gjermani. Ekspertët tjerë që kontribuan në këtë sesion trajnues ishin kryetari i gjykatës së qarkut në Prishtinë dhe dy trajnues gjyqësor nga IGJK. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve që morën pjesë ishte njëzet e nëntë (29).

### Seminar për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje

IGJK ka programe të posaqme të edukimit ligjor për gjyqtarët që punojnë në gjykata për kundërvajtje në tërë Kosovën. Seminari i mbajtur më 9 dhjetor 2004 ishte i fundit për vitin 2004 dhe kështu mbylli ciklin për trajnimet e gjyqtarëve të gjykatave për kundërvajtje. Programi trajnues adresoi çështje ligjore dhe procedurale në kompetencën e gjykatave për kundërvajtje, duke përfshirë edhe



çështjet e trafikut si dhe rendit dhe qetësisë publike. Një nga prezantuesit u përqëndrua në Kodin e ri të Procedurës Penale të Kosovës dhe procedurën e gjykatave për kundërvajtje. Prezantimet u mbajtën nga tre gjyqtar nga gjykata e lartë për kundërvajtje në Kosovë dhe një ekspert i lëmisë penale. Në këtë training ishin ftuar për pjemarrje, njëzet e katër (24) gjyqtar.

#### Punëtori rreth Kodit të përkohshëm të procedurës penale

Më datën 13 dhe 14 dhjetor IGJK së bashku me Këshillin e Evropës dhe në bashkëpunim me shoqatën e gjyqtarëve, atë të prokurorëve dhe odën e avokatëve të Kosovës organizuan një punëtori rreth Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, për gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Prishtinës. Kjo punëtori kryesisht u përqëndrua në paraburgimin. Gjyqtarët dhe prokurorët u ftuan që të analizojnë dhe të diskutojnë vendimet gjyqësore të cilat paraqesin dilema të cilat mund të hasen gjatë aplikimit të kodit të procedurës penale në çështjet e paraburgimit në fazën paraprake. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të arrihet standardizimi në interpretimin e dispozitave të reja penale dhe të ndihmoi zhvillimin e praktikave më të mira në mënyrë që të adresohen dispozitat të cilat shkaktojnë vështirësi në këtë fushë ligjore. Disa udhëzime për interpretimin ishin nxjerrur nga diskutimet. Qasje të përbashkëta se si të aplikohen këto dispozita do të publikohen nga IGJK.

#### **Ngjarjet e ardhshme**

##### Seminar nga e Drejta civile – ligji mbi trashëgiminë

Trajnimi i parë i vitit 2005 do të jetë një seminar rreth Ligjit mbi trashëgiminë dhe do të mbahet më 19 janar. Ky trajnim do të përqëndrohet në

implementimin praktik të dispozitave të këtij Ligji. Do të prezantohen disa raste nga ekspertët – një avokat dhe kordinatori i programit. Njëzet e pesë gjyqtar të lëmisë civile janë ftuar të marrin pjesë në këtë sesion trajnues.

##### Punëtori rreth Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës

Më datën 26 dhe 27 janar 2005 IGJK në bashkëpunim me shoqatën e gjyqtarëve atë të prokurorëve dhe odën e avokatëve të Kosovës do të organizojnë një punëtori rreth kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, për gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Mitrovicës. Kjo punëtori do të përqëndrohet në shqyrtimin kryesor. Pjesëmarrësit do të shohin një emitim të një gjykimi dhe do të prezentohen raste të ndryshme të cilat do të nxisin diskutime të problemeve të ndryshme rreth dilemave specifike sa i përket shqyrtimit kryesor.

##### Punëtori rreth pronës, Ligji kadastral dhe ai i hipotekave;

Kjo punëtori do të iu mundësoi pjesëmarrësve që të kenë diskutime rreth pengesave kryesore me të cilat ballafaqohen gjyqtarët kur kanë të zgjidhin ndojnë rast të ndërlikuar me pronën. Siç është për shembull: ku të dhënat e nevojshme për regjistrimin e pronës nuk janë të kompletuara apo mungojnë; vështirësitë në bashkëpunimin me Drejtoratin për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB) etj. Kjo punëtori do të siguroi një mundësi për pjesëmarrësit që të shkëmbejnë përvojat e tyre me kolegët dhe mëton të prodhoi një listë të çështjeve të cilat duhet të zgjidhen në praktikë. Si ushtrim praktik do të prezantohen mjetet për mbrojtjen e pronës private dhe transformimi i pronës shtetërore në pronësi private dhe do të prezantohen edhe forma tjera të pronës.

*Instituti Gjyqësor i  
Kosovës ju dëshiron  
suksese të shumta në  
vitin 2005*